

OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGIJE ELEKTRIKE
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Mbështetur në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin publik” i ndryshuar, neni 58, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 21 i tij, njoftojme:

Operatorin Ekonomik “El-POWER” sh.p.k, me adrese: Tiranë, Bulevardi Zogu I (pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës) dhe me NIPT L12009008K.

Procedura e prokurimit: “E Hapur -Mallra me mjete elektronike”

Numri i referencës së procedurës: REF-82556-08-09-2018

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 32 datë 13 Gusht 2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje Çelesa per seksionet komutuese TL/TM per N/Stacionet.”**, me fondin total 136,500,000 (Njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e pesëqind mije) leke pa tvsh., me afat realizimi 4 (Kater) Muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Publikime të mëparshme: **PO, Buletini Nr. 24 datë 18 Qershor 2018**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët**

Njoftojmë se, kane qënë pjesëmarrës në procedurë, me vlerën përkatëse të ofruar:

1. **OE: “El-POWER” sh.p.k** me nipt L12009008K, me vlere oferte 131,400,000 (Njëqind e tridhjetë e një milion e katerqind mije) leke pa TVSH.
2. **OE: “H&E ENERGY” sh.p.k** me nipt L71716029A, me vlere oferte 133,500,000 (njëqind e tridhjetë e tre milion e pesëqind mije) leke pa TVSH.
3. **OE: “EVEREST” sh.p.k** me nipt J78311921L, me vlere oferte 134,900,000 (Njëqind e tridhjetë e kater milion e nentëqind mije) leke pa TVSH.

Eshte skualifikuar ofertuesi si mëposhtë:

OE: “H&E ENERGY” sh.pk pasi:

Ne dokumentat standarte te tenderit, shtojca 9 “Kriteret e pergjithshme te kualifikimit”, pika 2 “Kriteret e Veçanta te Kualifikimit”, pika 2.2 “kapaciteti ekonomik dhe financiar”, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik sipas shkronjes “b” duhet të dorëzojë: vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore, per tre vitet e fundit, ku xhiroja mesatare e tre viteve të mos jete me vlerë më të ulët se 54,000,000 (Pesëdhjetë e kater milion) leke.

Nisur nga sa mesiper, operatori ekonomik “H & E ENERGY” shpk sipas LPP, i ndryshuar, nenit 27, pika 5, shkronja c” te VKM nr. 914, e ndryshuar, nuk ploteson kriterin e xhiros mesatare te tre viteve te fundit ne vleren e 54,000,000 leke.

Ne dokumentat standarte te tenderit, shtojca 9 “Kriteret e pergjithshme te kualifikimit”, pika 2 “Kriteret e Veçanta te Kualifikimit”, pika 2.3 “kapaciteti teknik”, pika 1 “pervoja te meparshme”,

operatori ekonomik duhet të dorëzojë furnizime të ngjashme për një vlerë jo më të vogël se 54,000,000 (Pesedhjetë e kater milion) leke që është realizuar gjatë tre viteve te fundit.

Nisur nga sa mesiper, operatori ekonomik “**H & E ENERGY**” shpk sipas nenit 46 te LPP, i ndryshuar, nenit 27, pikes 4, te VKM nr. 914, e ndryshuar, nuk ploteson kriterin e furnizimeve te ngjashme, pasi vlera totale e furnizimit te mallit te ngjashem pa tvsh eshte 49,450,500 leke nga 54,000,000 leke te kerkuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE: “EI-POWER” sh.p.k.**, me adrese: Tiranë, Bulevardi Zogu I (pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës) me NIPT L12009008K se Oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 131,400,000 (Njëqind e tridhjetë e nje milion e katerqind mije) leke pa TVSH, piket totale te mara 100 pike, është identifikuar si oferte e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Operatorit te Shperndarjes se Energjise Elektrike me adrese: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane, (Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese, Njesia e Prokurimit) kopjen e nënshkruar të formularit të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 12.09.2018

Ankesa: Nuk ka pasur.